




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-020/04-0039236-2/26 dt. 20.07.2026
Mitrovicë


Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, dhe Ligji nr. 02/L-88 për Trashëgimin Kulturore, Propozim Vendimin Nr. 01-020/04-0039236/26, të datës 08.07.2026 dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës dhe Turizmit, Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve dhe Qendrën Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, Propozim - Vendimin Nr. 01-020/04-0039236/26, dt. 08.07.2026 nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport Kryetari i Komunës, sjell këtë:

V E N D I M

(Për formimin e Grupit Punues punues ndër-institucional dhe profesional për përgatitjen e dokumentacionit teknik dhe profesional i cili do të shërbejë si bazë për hartimin e projektit të konservimit, restaurimit, muzealizimit dhe rifunksionalizimit të ndërtesës së ish- "Shtëpia e Armatës", në Muze të Qytetit të Mitrovicës së Jugut)

1. **Formohet** Grupi Punues ndër-institucional dhe profesional për përgatitjen e dokumentacionit teknik dhe profesional i cili do të shërbejë si bazë për hartimin e projektit të konservimit, restaurimit, muzealizimit dhe rifunksionalizimit të ndërtesës së ish- Shtëpisë së Armatës në Muze të Qytetit në Komunën e Mitrovicës së Jugut, në këtë përbërje:
 - 1.1. Nora Prekazi – kryesuese, (Drejtoreshë e Muzeut të Qytetit të Mitrovicës);
 - 1.2. Arbër hajra – anëtar, (Udhëheqës i Sektorit të Kulturës);
 - 1.3. Nexhmi Hasani – anëtar, (Drejtorja për Planifikim dhe Urbanizëm);
 - 1.4. Merita Gorani Bajri – anëtare, (Instituti Arkeologjik i Kosovës);
 - 1.5. Laura Mlinaku – anëtare, (Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Mitrovicë);
 - 1.6. Blerina Bejtullahu – anëtare, (Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Mitrovicë);
 - 1.7. Naser Hajdari – anëtar, (Drejtor i Qendrës së Kulturës "Rexhep Mitrovica");
 - 1.8. Enis Kelmendi – anëtar, (Historian);
 - 1.9. Leunita Sylaj – anëtare, (Përfaqësues nga OJQ);
 - 1.10. Kaltrina Igrishta – anëtare, (Arkeologe);
 - 1.11. Lekë Shala – anëtar, (Arkeolog).

2. Grupi Punues ka për detyrë:
 - 2.1. Përgatitjen e Detyrës Projektuese për hartimin e projektit të konservimit dhe restaurimit të ndërtesës së ish "Shtëpia e Armatës", aset i trashëgimisë kulturore;
 - 2.2. Përgatitjen e Detyrës Projektuese për muzealizimin, kurimin, riinterpretimin e ekspozitave dhe rifunksionalizimin e Muzeut të Qytetit të Mitrovicës;
 - 2.3. Hartimin e kushteve, kritereve teknike dhe standardeve profesionale për ndërhyrjet e planifikuara në ndërtesën si aset i trashëgimisë kulturore, përmbajtjen muzeore, ekspozitat dhe hapësirat funksionale të Muzeut të Qytetit të Mitrovicës;
 - 2.4. Sigurimin e koordinimit institucional dhe profesional ndërmjet Komunës së Mitrovicës së Jugut, Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit, Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Mitrovicë, si dhe institucioneve dhe ekspertëve të tjerë nga fushat relevante;
 - 2.5. Përgatitjen e rekomandimeve profesionale për fazat e projektimit, zbatimit dhe mbikëqyrjes së projektit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.
3. Grupi Punues obligohet të zhvilloj punën në bashkëpunim të ngushtë me institucionet kompetente të trashëgimisë kulturore dhe të respektoj standardet dhe parimet ligjore për konservimin dhe restaurimin e monumenteve të trashëgimisë kulturore.
4. Grupi Punues në përfundim të punëve obligohet ta dorëzoj dokumentacionin e përgatitur dhe raportin përfundimtar të punimeve Kryetarit të Komunës dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
5. Grupi Punues i formuar sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi bazë për punën e tij do të ketë Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligji nr. 02/L-88 për Trashëgimin Kulturore, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.
6. Koordinimin administrativ dhe teknik të Grupit Punues e bën drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
7. Mandati i Grupit Punues të formuar sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi do të zgjas nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij Vendimi deri në përfundim të detyrave të përcaktuara me këtë Vendim.
8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Kryetari i Komunës

Faton PEÇI